

Aneks

Plan veprimi për mbështetje të transformimit të Ballkanit Perëndimor	
Aktivitetet kryesore	Korniza kohore
1. Përforsim i mbështetjes për sundimin e ligjit	
1.1. Mbështetje për krijimin e planeve të detajuara të veprimit në Ballkanin Perëndimor për zgjidhjen e mangësive dhe prioritizimin e çështjeve kryesore për harmonizimin e legjislacionit dhe praktikave ekzistuese me standardet e BE-së.	2019-20
1.2. Zgjerimi i misioneve këshilluese në fushën e sundimit të ligjit në Ballkanin Perëndimor dhe inkurajimin e rritjes së mbështetjes nga ekspertë nga vendet anëtare.	2019-20
1.3. Forcimi i monitorimit të reformave përmes misioneve më sistimore, më vlerësuese të bazuar në rast	2018-19
1.4. Futja e monitorimit në gjykime në fushën e korrupsionit të rëndë dhe krimit të organizuar	2019-20
1.5. Të punohet drejt matjes më të mirë të rezultateve në reformën gjyqësore.	2018-19
1.6. Të punohet në drejtim të përdorimit më të mirë të kushtëzimit në negociatat për anëtarësim , veçanërisht duke siguruar rezultate konkrete në reformën gjyqësore dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, para se përkohësisht të mbyllet bisedimet teknike për kapitujt tjerë	2018
1.7. Zhvillimi i mbështetjes për Ballkanin Perëndimor përmes Fondacionit evropian për demokraci në fushën e mediave së pavarura dhe pluraliste dhe shoqërisë civile.	2018-19
2. Përforsimi i angazhimit për siguri dhe migracion	
2.1. Intensifikimi i punës së përbashkët për të luftuar terrorizmin dhe për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Duhet të krijohen ose përforcohen koordinatorët kombëtarë dhe zyrat për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe të krijohet një rrjet rajonal i koordinatorëve kombëtarë me mbështetjen e Rrjetit të BE-së për ndërgjegjësimin e radikalizmit dhe Eksperti rajonal i BE-së mbi luftën kundër terrorizmit. Të zhvillohen plane të përbashkëta veprimi për të luftuar terrorizmin.	2018-19
2.2. Në mënyrë të konsiderueshme të forcohet bashkëpunimi operativ , duke përfshirë edhe agjencitë e BE-së, në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, veçanërisht trafikut të armëve, trafikut të drogës, kontrabandimit të emigrantëve dhe trafikimit të njerëzve.	2018-19
2.3. Të vendosen oficerë të ndërlidhjes në Europol në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.	2019
2.4. Të inkurajohet finalizimi i marrëveshjeve për bashkëpunim me Evrodrejtësinë	2019-20
2.5. Avancimi i mëtejshëm i Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit (EPH) që i përfshijnë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vendet anëtare të BE-së. Kjo duhet të përfshijë përfshirjen aktive të Evrodrejtësisë dhe Europolit në përputhje me mandatet e tyre.	2018-19
2.6. Sa më shumë të jetë e mundur të përhapet cikli i politikës së BE-së mbi krimin e organizuar , që ta përfshijë Ballkanin Perëndimor në aktivitetet e saja operative. Të ftohet BP që të marrë pjesë në projektet e Platformës multidisiplinare Evropiane kundër kërcënimeve kriminale dhe në mbledhjet e Komitetit të Përhershëm për bashkëpunim operativ mbi sigurinë e brendshme (COSI) duke përfshirë edhe ato të mbajtura së bashku me Komitetin për sigurinë politike në baza ad-hok, kur të diskutohen projektet.	2018
2.7. Rritja e mbështetjes për ndërtimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë kibernetike dhe luftën kundër krimit kibernetik , duke përfshirë bashkëpunimin me Grupin Evropian për trajnimin dhe edukimin mbi krimin kibernetik, me qëllim të pjesëmarrjes në Agjencinë	2018-19

Evropiane për sigurinë e rrjeteve dhe informacioneve.	
2.8. Përforsim i bashkëpunimit në fushën e migracionit dhe menaxhimit të kufijve , me përforsimin e rrjedhës së informatave strategjike dhe taktike në parandalimin dhe luftimin e migrimit ilegal dhe kthimin e shtetasve të vendeve të treta, në veçanti përmes lidhjes së marrëveshjeve për statusin me Agjencinë Evropiane për roje kufitare dhe bregdetare.	2018-19
2.9. Përforsim i mëtejshëm i bashkëpunimit mes të oficerëve ndërlidhës të vendosur nga ana e (Agjencisë Evropiane për roje kufitare dhe bregdetare) vendet anëtare dhe autoritetet kompetente të Ballkanit Perëndimor.	2018
2.10. Ngritja e qendrave koordinuese kombëtare për kontrollin e kufijve në vendet e BP-së, duke i lidhur përmes një rrjeti rajonal me qendrat kombëtare të bashkërendimit për shkëmbimin e informacionit në vendet anëtare fqinje.	2019
2.11. Në mënyrë që të vazhdojmë me aktivitetet e ndryshme, që duhen ndërmarrë agjencitë e BE-së, të formohet një grup pune ndër-agjencish i BE-së , i koordinuar nga Komisioni që do ti përfshijë Europolin, Agjencia Evropiane për roje kufitare dhe bregdetare, Evrodrejtësia, Qendra evropiane e monitorimit për drogat dhe varësinë nga droga, Agjencia e Bashkimit Evropian për trajnim për zbatimin e ligjit.	2019
2.12. Vlerësim i Planit të veprimit 2015-2019 për trafikim të paligjshëm me armë për të përgatitur rinovimin e tij në vitin 2019 me qëllim të zgjidhjes më efikase të furnizimit me armë të paligjshme, dhe rezervat e mëdha të armëve .	2018-19
2.13. Dialogu i strukturuar për Politikën e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë/Politika e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes të zgjerohet dhe thellohet me Ballkanin Perëndimor, me rritjen e pjesëmarrjes në misionet dhe operacionet e BE-së në mbarë botën.	2018
2.14. Të zhvillohet pjesëmarrje e mëtejshme në aktivitete që lidhen me kërcënimet hibride, inteligjencën, çështjet hapësinore, reformën e sektorit të mbrojtjes dhe të sigurisë.	2018
3. Mbështetja e zhvillimit socio-ekonomik	
3.1. Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor do të zgjerohet që ti tërheq dhe koordinojë edhe më tej investimet e donatorëve dypalësh dhe institucionet financiare ndërkombëtare.	2019
3.2. Në mënyrë domethënëse të përforsohet Korniza e investimeve për Ballkanin Perëndimor si një garanci për të tërhequr investimet private .	2019
3.3. Të përforsohen masat për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat , duke përfshirë një skemë për mbështetje të bizneseve fillestare në rajon dhe mbështetje të përpjekjeve që synojnë specializimin e zgjuar.	2019
3.4 Rritja e qasjes në financa dhe shfrytëzimin e potencialit të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.	2018
3.5. Integrimi i mëtejshëm i Ballkanit Perëndimor në rrjetet e njohjes së BE-së dhe mbështetjen për ndërtimin e kapaciteteve për hulumtim dhe inovacion për shkak të pjesëmarrjes efektive në programet kornizë të BE-së.	2018
3.6. Mobilizim i ekspertizës së BE-së, për të mbështetur zbatimin e Zonës ekonomike rajonale.	2018
3.7. Lehtësimin e tregtisë mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe në rajon, duke përfshirë edhe zhvillimin e programeve për njohjen e ndërsjellë të bazuar në CEFTA dhe Zonën ekonomike rajonale (p.sh. operatorë ekonomik të autorizuar).	2018
3.8. Mbështetja e mëtejshme e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë në procesin e tyre të anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë	2018
3.9. Përmes dialogut të përforsuar dhe aktiviteteve në terren, përforsimin e ndihmës për	2018

Ballkanin Perëndimor për të siguruar konvergjencën e kontrollit të eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë .	
3.10. Përforsim i mëtejshëm i programit për reforma ekonomike me përafrimin e saj, drejt semestrit ekzistues Evropian për vendet anëtare të BE-së, përforsimin e asistencës teknike dhe integrimin e mëtejshëm të prioritetëve të programeve të reformave ekonomike dhe të drejtimeve politike të ministrive në programimin e Instrumentit për ndihmë para-anëtarësimi.	2018-19
3.11 Të rritet fokusi i punësimit dhe reformave sociale përmes monitorimit më të madh të politikave përkatëse dhe caktimin e takimit vjetor ministror të BE-BP-së, për këto çështje që do të përfshihen në programin e reformave ekonomike.	2019
3.12. Të sigurohet ndihmë më e madhe financiare në fushat sociale në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë shëndetësinë	2019-20
3.13. Të rritet mbështetja për arsimim, veçanërisht nisjen e pilot projekteve për mobilitet në arsimin profesional dhe trajnim .	2019
3.14. Financimi i dyfishtë përmes Erazmus + programit.	2019-20
4. Rritja e lidhjes	
4.1. Mbështetje për përdorimin në rritje të mundësive të Instrumentit për lidhjen e Evropës në Ballkanin Perëndimor, në përputhje me objektivat përkatëse të strategjive makro-rajonale të BE-së.	2018
4.2 Zgjerimi i të gjitha dimensioneve të Komunitetit energjetik të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor: siguria energjetike, hapje e tregjeve dhe tranzicion energjetik - duke përfshirë efikasitet energjetik dhe burimet e ripërtërishme të energjisë.	2019-20
4.3. Mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së autoriteteve dhe organizatave nga Ballkani Perëndimor në aktivitetet e rrjetit të rregullatorëve energjetik dhe operatorëve të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes , veçanërisht Agjencia për bashkëpunim të rregullatorëve energjetik dhe Rrjeti evropian i operatorëve të sistemit të transmisionit.	2018-19
4.4. Të punohet drejt përfundimit të Tregut rajonal të energjisë elektrike në Ballkanin Perëndimor dhe të sigurohet, se tregu i Ballkanit Perëndimor është i integruar në tregun e brendshëm të energjisë elektrike të BE-së.	2018-19
4.5 Mbështetje e mëtejshme për krijimin e një hapësire të vetme rregullatore dhe proces-efektiv i reformave të tregut energjetik, në bazë të Marrëveshjes të komunitetit energjetik .	2018
4.6. Mbështetje për zbatimin e Marrëveshjes së komunitetit të transportit dhe funksionalitetin e plotë të sekretariatit të tij.	2018-19
4.7. Inkurajimi i mëtejshëm i pjesëmarrjes së Ballkanit Perëndimor në takime të ndryshme dhe forume të transportit të komitetit për rrjete transportuese trans-evropiane .	2019
4.8. Mbështetje për rritjen e konkurrencës nëpërmjet masave të përmirësuara për heqjen e barrierave në kufijtë , sidomos vendkalimet kufitare të integruara rrugore dhe hekurudhore.	2018-19
4.9. Mbështetja e strategjisë së re për hekurudha, për përfshirjen e Ballkanit Perëndimor në rrjetin kryesor dhe tregun e BE-së përmes integritit progresiv në Korridoret Orient /Mesdheu Lindor dhe korridori i mesëm mesdhetar i BE-së.	2018
4.10. Të shqyrtohet mundësia e pjesëmarrjes në Ballkanin Perëndimor në Agjencitë evropiane të transportit .	2018
04.11. Mbështetje për krijimin e një strategjie për sigurinë rrugore , duke përfshirë aktivitete për të reduktuar numrin e viktimave në rrugë duke hequr pikat e zeza në rrugët.	2018-19
5 . Agjenda digjitale për Ballkanin Perëndimor	

5.1. Lëshimi i Agjendës digjitale për Ballkanin Perëndimor , duke përfshirë edhe një udhërrëfyes për lehtësimin e reduktimit të kostove roaming.	2018
5.2. Mbështetje për internet të brezit të gjerë në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë integrimin në rrjetin e departamenteve përkatëse për internet të brezit të gjerë.	2018-19
5.3. Mbështetja e zhvillimit të e-qeverisë, e-prokurime, e-shëndetësi dhe artet digjitale në Ballkanin Perëndimor.	2018-19
5.4. Të mbështetet ndërtimi i kapaciteteve për besimin digjital dhe siguri , së bashku me përpjekjet për përmirësimin e digjitalizimit të industrive.	2018-19
5.5. Rritja e mbështetjes për përshtatje, implementimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së, në fushën e tregut digjital të vetëm .	2018-19
6. Mbështetje për pajtim dhe raporte të mira fqinjësore	
6.1. Të mbështeten nismat për nxitje të pajtimit dhe drejtësisë tranzicionale, siç është formimi i Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut në territorin e ish-Jugosllavisë (KOMRA).	2018-19
6.2 Të mbështetet lufta kundër mosndëshkimit , duke mbështetur Mekanizmin për Gjykatat ndërkombëtare penale, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ndërmjet prokurorëve kombëtar dhe për informimin e publikut, dhe me odat e specializuara për Kosovën.	2018-19
6.3 Të punohet drejt një zgjidhjeje rajonale për zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur dhe minave tokësore .	2018-19
6.4. Më tej të mbështeten nismat e pajtimit, duke përfshirë zgjerimin e fushës dhe gamës së Zyrës rajonale për bashkëpunim të rinisë dhe futjen e skemës rajonale për mobilitet.	2018-19
6.5. Të përforcohet bashkëpunimi në kulturë dhe sporte, duke përfshirë aktivitetet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Ballkanin Perëndimor, luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurisë kulturore dhe promovimin e industrive kulturore dhe kreative, duke përfshirë pjesëmarrjen në programin Evropa Kreative .	2018
6.6. Vendet e Ballkanit Perëndimor do të jetë të lidhura plotësisht me Vitin evropian të trashëgimisë kulturore dhe do të përfshihen në të gjitha ngjarjet dhe nismat përkatëse. Të nisët Ruta e trashëgimisë BE-Ballkani Perëndimor , i cili do të përbëhet nga një seri ngjarjesh që e festojnë trashëgiminë kulturore në të gjitha format e saja.	2018